



***Udhëzuesi i EFN për implementimin e Artikullit 31 mbi njohjen  
reciproke të kualifikimeve profesionale të  
Udhëzuesit 2005/36/EC, ndryshuar në Udhëzuesin 2013/55/EU***

Struktura e Kompetencave të EFN  
E miratuar nga Asambleja e Përgjithshme EFN, Prill 2015, Bruksel



---

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet në shtyp, me anë fotostatike ose në ndonjë mënyrë tjetër, ose të ruhet në një sistem arkivimi, ose të transmetohet në çfarëdo forme, apo të shitet pa lejen me shkrim të Shoqatës Federale Europiane të Infermiereve (EFN) . Fragmente të shkurtra mund të riprodhohen pa autorizim, me kusht që të tregohet burimi.

Copyright © EFN 2015 Shoqatës Federale Europiane e Infermiereve

Ky dokument do të referohet si: Shoqatës Federale Europiane e Infermiereve (2015), Kuadri i Kompetencave të EFN. Udhëzimi për zbatimin e Nenit 31 në programet e arsimit kombëtar të infermierëve. Bruksel, Belgjikë.

<b>1. Konteksti racional dhe politik</b>	<b>3</b>
<b>2. Historia e dokumentit</b>	<b>4</b>
<b>3. Kompetencat e përfshira në direktivën 2013/55/EU</b>	<b>6</b>
<b>4. Përjasje për modelin e kompetencave</b>	<b>8</b>
<b>5. Marrëdhënia midis kompetencave të direktivës 2013/55/EU dhe atyre të strukturës të EFN</b>	<b>9</b>
<b>6. Marrëdhënia midis kompetencave dhe përmbajtja e kurrikulave edukuese dhe trajnuese</b>	<b>16</b>
<b>7. Marrëdhënia midis kompetencave, përmbajtja e kurrikulave edukuese dhe trajnuese, si dhe rezultatet potenciale të të mësuarit</b>	<b>22</b>
<b>Fjalor i termave kryesore</b>	<b>35</b>



## 1. Konteksti racional dhe politik

Një udhëzim i amenduar për Kualifikimet Profesionale është adoptuar në fund të 2013 dhe përfshin një set me 8 kompetenca në pjesën kryesore të udhëzimit (Artikulli 31). Këto kompetenca janë të detyrueshme me ligj dhe vendet anëtare duhet të sigurohen, që këto kompetenca të implementohen brenda afatit përfundimtar për implementim (18 janar 2016). Komisioni ka gjithashtu autoritetin për të përditësuar Shtojcën V të udhëzimit përmes një Akti të Deleguar.

Grupit ekzistues të punës për kompetencat i kërkohet që:

1. Të shqyrtojë strukturën e draftit EFN të kompetencave, lidhjen e tij me kompetencat e mishëruara në Artikullin 31, të hartojë një Udhëzues për implementimin e Artikullit 31 në programet kombëtare të edukimit të infermierëve dhe të formulojë një propozim për Asamblenë e Përgjithshme të EFN për përditësimin e Shtojcës V.
2. Të marrë në konsideratë se me cilat nga palët e interesuara EFN apo shoqatat anëtare duhet të bashkëpunojë për projektimin e strukturave paraprirëse për implementimin dhe një përputhje sa më të mirë me Udhëzimin.
3. Të identifikojë çështjet kontekstuale, të cilat do ta mundësojnë apo pengojnë implementimin e këtyre kompetencave në programet kombëtare të infermieristikës.

Grupi i punës EFN (GP) ka përmbushur pjesën e parë të këtyre objektivave dhe kërkon të diskutojë për grupet kyçe të interesit apo çështjet kontekstuale, përfshirë këtu edhe nevojën për një mënyrë të caktuar, e cila të tregojë nëse kompetencat janë vënë në zbatim, si dhe nevojën për zgjerimin e kapaciteteve sidomos në shkollat e infermierisë. Ky dokument përshkruan udhëzimin e EFN për implementimin e Artikullit 31, në programet kombëtare të edukimit të infermierëve.

EFN GP (grupi i punës EFN) për kompetencat - Kryetari: Prof Maximo Gonzales Jurado

Komiteti Profesional EFN – Udhëheqës: Znjsh Herdis Gunnarsdottir

## Historia e dokumentit

Fillimet e modernizimit të Direktivës 2005/36/EC filluan me konsultën publike të BE (Mars 2011), e cila solli disa sfida në procesin e njohjes, si dhe domosdoshmërinë për të përditësuar kërkesat arsimore të profesioneve që mbulohen nga sistemi automatik, në mënyrë që të njihemi me evoluimin e këtyre profesioneve në përputhje me kërkesat e edukimit, si dhe fokusohet tek fakti se, përmbajtja e Shtojcës V për edukimin e infermierëve duhet të përditësohet për të pasqyruar zhvillimet e kohëve të fundit në infermieristikë, si p.sh. fokusimi tek kujdesi shëndetësor i orientuar drejt parandalimit, kujdesi afatgjatë, kujdesi për komunitetin, mjekësia elektronike & zhvillimet ICT, siguria e pacientit, praktika e bazuar tek kërkimi dhe evidenca, etj.

Gjatë procesit të modernizimit, negociimi i propozimit të Komisionit me Parlamentin Europian dhe Këshillin, rezultoi me forcimin e kërkesave për edukimin e infermierëve si dhe shtimin e setit prej 8 kompetencash. EFN është përfshirë shumë në përmirësimin e këtyre kompetencave dhe mban kontakte të përditshme me Z. Jurgen Tiedje, kryetarin e Njesisë së Këshillit Europian për Negocimin. Për këto përgatitje, anëtarët e EFN përpunuan dhe aprovuan një Strukturë Kompetencash të EFN (e aprovuar në prill 2012), e cila u përdor gjatë negociatave dhe u prezantua në Parlament, Këshill, Komision dhe në grupet e interesit gjatë një tryeze të rrumbullakët të Parlamentit Europian për edukimin e infermierëve të organizuar nga EFN në tetor 2012.

Menjëherë sapo Direktiva e modernizuar u aprovua, fokusi kryesor i EFN ishte të sigurohej se të gjitha ndryshimet janë pasqyruar në legjislacionin e çdo shteti anëtar. Përditësimi i Shtojcës V u bë prioriteti më i ri në këtë fushë, dhe anëtarët e EFN formuan grupin e ri të punës për kompetencat (Kryetar: Maximo Gonzales Jurado; Zv Kryetar: Herdis Gunnarsdottir; Anëtarë: Branka Rimac, Carol Hall, Brigitta Wedahl, Bruno Gomez, Miklos Bugarzsky dhe Yves Mengal). Gjatë Asamblesë së Përgjithëshme EFN, të mbajtur në 10-11 prill 2014 në Bruksel, takimi i parë i kushtua kompetencave të përfshira në Artikullin 31 dhe u bë një analizë e strukturave për kompetencat EFN.

---

<sup>1</sup> Struktura e kompetencave EFN u zhvillua duke marrë në konsideratë dokumentat ekzistuese të kompetencave infermiore të zhvilluara ICN, WHO, Projektet Tunning, etj. Vëmendje e veçantë i është kushtuar punës së realizuar nga Dr Mercedes Gomez Del Pulgar në zhvillimin e kompetencave infermiore.

Analiza theksoi shumë ngjashmëri dhe reflektoi në dhënien e propozimeve për t'i bërë Strukturat e Kompetencave të EFN, linjë udhëheqëse në implementimin me lehtësi të ndryshimeve në Direktivën për kurrikulat kombëtare të infermieristikës. Dokumenti shkon me tej deri në vendosjen e një shtegu logjik, i cili bën lidhjen e kompetencave me listat përkatëse të temave për edukimin e infermierëve dhe rezultateve potenciale të të mësuarit.

## 1. Kompetencat e përfshira në Direktivën 2013/55/EU

Kompetencat e përfshira në Direktivën 2013/55/EU

Direktiva e modernizuar përfshin një set prej 8 kompetencash në Artikullin 31 (paragrafi 7), i cili përcakton kërkesat minimale për edukimin e infermierëve që punojnë në kujdesin e përgjithshëm shëndetësor. Paragrafi 6, përmendet në listën e kompetencave dhe jepet më poshtë si informacion për lexuesit.

**6.** Trajnimi për infermierët e kujdesit të përgjithshëm shëndetësor duhet të sigurojë që personi në fjalë ka fituar njohuritë dhe aftësitë e mëposhtme:

**(a)** Një kuptim të përgjithshëm të shkencave mbi të cilat bazohet infermiera e përgjithshme si dhe njohuri të mjaftueshme të strukturës, funksioneve fiziologjike dhe sjelljes së personave të shëndetshëm apo të sëmurë si dhe të marrëdhënies midis gjëndjes shëndetësore dhe mjedisit social dhe fizik të qënies njerëzore.

**(b)** Njohuri të mjaftueshme për natyrën e etikës së profesionit dhe parimet e përgjithëshme të shëndetit dhe infermieristikës.

**(c)** Eksperiencën e duhur klinike, vlerat e së cilës mund të zgjidhen për trajnim dhe që mund të fitohen nën vëzhgimin e stafit të kualifikuar të infermierëve në ato vende ku numri i personave të kualifikuar dhe aparaturat janë të përshtatshme për kujdesin ndaj pacientit.

**(d)** Aftësinë për të marrë pjesë në praktikat e trajnimit të personelit shëndetësor dhe eksperiencë pune me të tillë personel.

**(e)** Eksperiencë pune me anëtarë të profesioneve të fushave të tjera të shëndetit.

**7.** Kualifikimet formale të një infermieri që punon në kujdesin e përgjithshëm shëndetësor, duhet të evidentojnë që profesionisti në fjalë është i aftë të aplikojë kompetencat e mëposhtme, pavarësisht faktit nëse trajnimi është zhvilluar nëpër universitete, në institucione të arsimit të mesëm që kanë të njëjtin rang, në shkollat verore apo në programet trajnuese të punësimit të infermierëve.

**A.** Të jetë kompetent në vendosjen në mënyrë të pavarur të diagnozës, duke përdorur njohuritë teorike dhe klinike si dhe të planifikojë, të organizojë dhe implementojë kujdesin shëndetësor ndaj pacientëve, në bazë të njohurive dhe aftësive të fituara sipas pikave (a), (b) dhe (c) të paragrafit 6, në mënyrë që të përmirësojë sa më shumë praktikën profesionale.

- B.** Të jetë kompetent për të punuar me rendiment me aktorët të tjerë të sektorit shëndetësor, përfshi këtu dhe pjesëmarrjen në praktikat trajnuese të personelit shëndetësor mbi bazë të njohurive dhe aftësive të fituara sipas pikave (d) dhe (e) të paragrafit 6.
- C.** Të jetë kompetent në orientimin e individëve, familjeve dhe komunitetit drejt jetës së shëndetëshme dhe kujdesit ndaj vetes në bazë të njohurive dhe aftësive të fituara sipas pikave (a) dhe (b) të paragrafit 6.
- D.** Të jetë kompetent që në mënyrë të pavarur të marrë masa për shpëtimin e jetëve në raste krizash apo fatkeqësish.
- E.** Të jetë kompetent që në mënyrë të pavarur të këshillojë, të instruktojë dhe të mbështesë personat që kanë nevojë për përkujdesje, si dhe të afërmit e tyre.
- F.** Të jetë kompetent që në mënyrë të pavarur, të vlerësojë dhe të japë një shërbim shëndetësor sa më cilësor.
- G.** Të jetë kompetent për bashkëpunim dhe komunikim profesional me punonjës të tjerë të sektorit shëndetësor.
- H.** Të jetë kompetent në analizimin e cilësisë së shërbimit, në mënyrë që të përmirësojë sa më shumë praktikën profesionale si infermier i kujdesit të përgjithshëm shëndetësor.

## 2. Përqasja ndaj një modeli kompetencash


Fjala “kompetencë” ka shumë kuptime, megjithëse secili prej tyre ka ngjyrimet e veta: dituri, njohuri, talent, vlerë, përqasje. Si rrjedhim, është e rëndësishme që të kuptojmë konceptin e “përdorimit” apo “vënies në punë” që ka të bëjë me ndërthurjen e të gjithë këtyre componentëve, në mënyrë që t’i përdorim ata në një kontekst të caktuar dhe të japim përgjigjen më të mirë të mundshme, duke e përkufizuar kompetencën si një “ndërlidhje midis njohurive, talentit, përqasjeve dhe vlerave, dhe si përfshirjen e këtyre komponentëve në një kontekst apo situatë reale të caktuar, duke arritur kështu në zgjidhjen më të mirë në situata dhe probleme të ndryshme, me të cilat mund të përballemi në çdo moment, si dhe duke përdorur burimet e disponueshme”. (Gomez del Pulgar, M, 2011)

Kompetencat e ndryshme që përfshihen në Direktivën 2013/55/EU, si dhe ato të strukturës së EFN, përshkruhen në seksionet pasuese dhe kanë si qëllim të bëjnë ndërlidhjen e tyre dhe të japin një përshkrim të plotë të rezultateve specifike të të mësuarit, që priten nga secila prej kompetencave, gjë kjo, që në fund do të na lejojë të përcaktojmë minimumin e nivelit të kompetencës.

## 8. Marrëdhënia midis kompetencave, përmbajtja e kurrikulave edukuese dhe trajnuese, si dhe rezultatet potenciale të të mësuarit.

Marrëdhënia midis kompetencave në Direktivën 2013/55/EU dhe atyre të Strukturës së Kompetencave të EFN.

Ndërlidhja e setit të 8 kompetencave të Artikullit 31 të Direktivës 2013/55/EU me listën e temave për edukimin e infermierëve që përmban Shtojca V, kërkon përpunimin e një logjike të caktuar dhe të një procesi reflektimi shumë të mirëmenduar. Ky proces fillon me 8 kompetencat, ndiqet nga përcaktimi i fushave që kanë lidhje me këto kompetenca dhe vazhdon me përshtatjen e çdo kompetence me zonën përkatëse, duke përshkruar të gjitha pritshmëritë e kompetencave si dhe nivelin e domosdoshëm të edukimit brenda kurrikulës dhe mbaron me listën e rezultateve potenciale të të mësuarit, të cilat do të provojnë përvetësimin e këtyre kompetencave.



*Fig1. Figura 1. Procesi i implementimit të Direktivës Art 31 2013/55/EU (lista e kompetencave) në kurrikulat e infermierëve.*

Pikëfillimi është vendosja e marrëdhënies midis 8 kompetencave të Artikullit 31 të Direktivës 2013/55/EU (nga A në H) dhe Strukturës së Kompetencave të EFN e cila përfshin:

Kapitulli 1: Kultura, etika dhe vlerat.

Kapitulli 2: Promocioni i shëndetit dhe parandalimi, drejtimi dhe mësimdhënia.

Kapitulli 3: Vendimmarrja.

Kapitulli 4: Komunikimi dhe puna në skuadër.

Kapitulli 5: Kërkimi, zhvillimi dhe lidërshipi.

Kapitulli 6: Kujdesi infermieror.

Këto kompetenca bazë përfshijnë edhe disa nënkompetenca të tjera, të cilat do të bëjnë që rezultatet e të mësuarit, të përputhen me përmbajtjen e kurrikulës së edukimit dhe të trajnimit, përputhje që na lejon të bëjmë vlerësime të mëtejshme.

Në rastin e Kompetencës së EFN N. 6: Kujdesi infermieror, janë propozuar 4 nëngrupe në mënyrë që kujdesi infermieror i rregulluar të ndiqet nga procesi i kujdesit infermieror sipas një rruge logjike.

Kapitulli 6.1- Vlerësimi dhe diagnoza.

Kapitulli 6.2- Planifikimi i kujdesit.

Kapitulli 6.3- Ndërhyrja e infermierit.

Kapitulli 6.4- Vlerësimi i përgjithshëm dhe ai i shërbimit.

Këto marrëdhënie paraqiten në tabelën e mëposhtme:

**Direktiva**                      **Zonat e kompetencës (CA) 2013/55/EU**  
**Struktura e Kompetencave të EFN**

**KOMPETENCA H**            CA. 1: Kultura, etika dhe vlerat

---

**KOMPETENCA C**            CA. 2: Promocioni dhe parandalimi  
shëndetësor, udhëzime dhe mësimdhënia

---

**KOMPETENCA A**            CA. 3: Marrja e vendimeve  
**KOMPETENCA F**

---

**KOMPETENCA B**            CA. 4: Komunikimi dhe puna në skuadër  
**KOMPETENCA G**

---

**KOMPETENCA A**            CA. 5: Kërkimi, zhvillimi dhe kompetenca  
**KOMPETENCA G**

---

<b>KOMPETENCA A</b>	CA. 6: Kujdesi infermieror (edukimi teorik dhe trajnimi)
<b>KOMPETENCA E</b>	
<b>KOMPETENCA D</b>	CA. 6.1. – Vlerësimi dhe diagnoza. CA. 6.2. – Plani i kujdesit. CA. 6.3. – Ndërhyrjet infermierore. CA. 6.4. – Vlerësimi i përgjithshëm dhe ai i shërbimit.
<b>KOMPETENCA A</b>	CA. 6: Kujdesi Infermieror (praktika klinike dhe edukimi)
<b>KOMPETENCA E</b>	CA. 6.1. – Vlerësimi dhe diagnoza. CA. 6.2. – Plani i kujdesit. CA. 6.3. – Ndërhyrjet infermierore. CA. 6.4. - Vlerësimi i përgjithshëm dhe ai i shërbimit.

*Tabela 1- Matrica e lidhjeve midis kompetencave të Artikullit 31 dhe nënfushave thelbësore të kompetencave (në lidhje me Strukturën EFN të Kompetencave)*

Ndarja e fushave të kompetencave sipas strukturës EFN të Kompetencave

Në mënyrë që të kemi listën e temave është e domosdoshme të bëjmë ndarjen e kompetencave në përputhje me fushat kryesore dhe t'i diskutojmë ato më tej duke u mbështetur në strukturën ekzistuese të kompetencave (Strukturën e Kompetencave sipas EFN). Ky veprim na jep një kuptim më të qartë të kompetencave dhe listës së temave dhe na lejon të bëjmë formulimet e mëtejshme të rezultateve të të mësuarit.

### **Kapitulli.1. Kultura, etika dhe vlerat.**

Të promovojë dhe respektojë të drejtat e njeriut dhe larmishmërinë, nën dritën e nevojave fizike, psikologjike, shpirtërore dhe sociale të individëve të pavarur, duke marrë në konsideratë opinionet, besimet, vlerat dhe kulturën e tyre, si dhe kodet kombëtare dhe ndërkombëtare të etikës, apo dhe implikimet etike për dispozitat e kujdesit shëndetësor; të sigurojë të drejtën e tyre për privatësi dhe të nderojë konfidencialitetin e informacionit të shërbimit shëndetësor.

Të marrë përgjegjësinë për të mësuar për gjatë gjithë jetës dhe zhvillimin e vazhdueshëm profesional.

Të marrë në konsideratë veprimet profesionale të gjithësecilit dhe të njohë limitet e tij në fushën e praktikës dhe të kompetencave.

### **Kapitulli.2. Promocioni i shëndetit dhe parandalimi, drejtimi dhe mësimdhënia.**

Të promovojë stilet e jetesës së shëndetëshme, masat parandaluese dhe ato për kujdesin ndaj vetes, të promovojë shëndetin duke theksuar përputhjen midis sjelljes dhe terapisë.

Të mbrojnë në mënyrë të pavarur shëndetin dhe mirëqënien e individëve, familjeve ose grupeve që përfitojnë kujdesin, duke u dhënë atyre siguri dhe duke promovuar autonominë e tyre.

Të integrojnë, të promovojë dhe të aplikojë njohuritë metodologjike dhe praktike. Kjo do të mundësojë promovimin dhe zhvillimin e kujdesit infermieror afatgjatë, sëmundshmërinë shoqëruese dhe situatat e ndërlidhjes, në mënyrë që të mundësojnë autonominë personale të individit dhe lidhjen e saj/të tij me ambientin në çdo moment të procesit të shëndetit/sëmundjes.

### **Kapitulli.3. Vendimmarrja**

Të aplikojë aftësinë e mendimit kritik dhe të përqsjes së sistemeve drejt zgjidhjes së problemeve si dhe të vendimmarrjes në infermieristikë, gjithmonë në kontekstin profesional dhe të shtrirjes së kujdesit.

Duke analizuar më parë problemet, të ndërmarrë veprime të cilat lehtësojnë gjetjen e zgjidhjeve më fitimprurëse për pacientin, familjen dhe komunitetin, arritjen e objektivave dhe përmirësimin e rezultateve duke ruajtur cilësinë e punës së tyre.

### **Kapitulli. 4. Komunikimi dhe puna në skuadër.**

Të jetë i aftë të kuptojë personat me të cilët do të komunikojë, të ndërveprojë dhe të punojë me efikasitet edhe në aspektin terapeutik, me kolegët dhe pjesën ndër-profesionale të stafit si dhe me individët, familjet dhe grupet.

T'u delegojë të tjerëve veprime në përputhje me nivelin e aftësive dhe të përgatitjes, kompetencave dhe të pikëpamjes ligjore të praktikës.

Të përdorë në mënyrë të pavarur arkivat elektronike të vlerësimit të infermierëve, të diagnozave, të ndërhyrjeve dhe rezultateve, duke u bazuar në sistemet klasifikuese krahasuese të infermierëve dhe të taksonomisë së infermierëve.

Të tërheqë, të aplikojë dhe të shpërndajë në mënyrë të pavarur çdo informacion ndërmjet pacientëve dhe profesionistëve të kujdesit shëndetësor, nëpërmjet lehtësirave të kujdesit shëndetësor dhe komunitetit.

Të koordinojë në mënyrë të pavarur kujdesin ndaj grupeve të pacientevë dhe të punojë në mënyrë ndërdisiplinare duke pasur gjithmonë qëllimin për të arritur sigurinë e pacientit dhe cilësinë e shërbimit.

#### **Kapitulli.5. Kërkimi, zhvillimi dhe lidërshtipi**

Të implementojë të rehat shkencore për praktikën e mbështetur tek evidencat.

Të marrë në konsideratë principet e barazisë dhe përmbajtjes të kujdesit shëndetësor dhe të përpiqet për përdorimin racional të burimeve.

Të adoptojë modele të caktuara të lidërshtipit dhe të përqsaje për çështje të ndryshme që lidhen me infermierët, praktikën klinike dhe kujdesin shëndetësor.

Të promovojë dhe të konsolidojë imazhin pozitiv të infermierit.

#### **Kapitulli.6. Kujdesi infermieror**

Të shfaqë njohuri dhe aftësi të mjaftueshme për të ushtruar kujdesin profesional, në përputhje me nevojat e kujdesit shëndetësor dhe infermieror ndaj individëve, familjeve dhe grupeve, për të cilat infermieri është përgjegjës, duke marrë parasysh edhe zhvillimet e fundit shkencore, si dhe kërkesat për sigurinë dhe cilësinë, të vendosura në përputhje me rregullat ligjore dhe profesionale.

Të vlerësojë, të diagnostikojë, të planifikojë dhe të sigurojë në mënyrë të pavarur kujdesin infermieror të integruar ndaj pacientit, duke u fokusuar tek rezultatet e arritura pas vlerësimit të situatës, të së shkuarës së pacientit dhe kujdesit që i është dhënë atij përmes udhëzimeve për kujdesin klinik, të cilat përshkruajnë proceset e diagnostikimit, të trajtimit/kujdesit dhe të japë rekomandime për kujdesin në të ardhmen.

Të njohë dhe të implementojë principet dhe parimet teorike dhe metodologjike bazë të infermieristikës, duke u bazuar në ndërhyrjet e infermierit, në evidencën shkencore dhe në gjithë burimet e tjera të mundshme.

- Të vendosë në mënyrë të pavarur mekanizmat dhe proceset e vlerësimit për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në

kujdesin infermieror, gjithmonë duke marrë në konsideratë zhvillimet e fundit shkencore, teknike dhe etike.

- Të kuptojë dhe veprojnë në përputhje me kontekstet sociale dhe kulturore të sjelljeve të individëve dhe të impaktit të këtyre sjelljeve në shëndetin e tyre, gjithmonë brenda kontekstit social dhe kulturor.
- Të kuptojë rëndësinë e ndihmës së sistemeve të kujdesit ndaj individëve, familjeve dhe grupeve ndërsa vlerëson impaktin e tyre.
- Të përgjigjet në mënyrën e duhur dhe në kohë, në situata të papritura dhe që ndryshojnë me shpejtësi.
- Të marrë në mënyrë të pavarur masa efikase në situata krize apo fatkeqësish në mbrojtje të jetës dhe cilësisë së saj.

## **Marrëdhënia midis kompetencave dhe përmbajtjes së kurrikulës së edukimit dhe trajnimit**

Këtu propozohet kurrikula e edukimit dhe trajnimit, me qëllim zhvillimin e kompetencave të infermierit.

Tabela e mëposhtme tregon lidhjen midis 8 kompetencave të Artikullit 31 dhe Direktivës së Amenduar 36 (nga A në H), Strukturën EFN të Kompetencave dhe përmbajtjen e kurrikulës së edukimit dhe trajnimit.

DIR2013/55/EU	EFN	PERMBAJTJA
<b>Kompetenca H</b>	Kapitulli 1:Kultura , etika dhe vlerat	Etika dhe filozofia e infermieristikës, të drejtat e njeriut. Autonomia e pacientit,të drejtat dhe siguria e tij. Aspektet ligjore të kujdesit shëndetësor dhe profesionit, legjislacioni social dhe i kujdesit shëndetësor. Konfidencialiteti
<b>Kompetenca C</b>	Kapitulli2:Promocioni i shëndetit dhe parandalimi, drejtimi dhe mësimdhënia	Parimet e shëndetit dhe sëmundjes, shëndeti publik, promocioni i shëndetit,kujdesi komunitar/parësor.Drejtimi i pacientit dhe edukimi shëndetësor. Perspektivat sociale dhe ndërsektoriale dhe influenca e tyre. Përfshirja dhe fuqizimi i qytetarëve.
<b>Kompetenca A</b> <b>Kompetenca F</b>	Kapitulli 3:Vendimmarrja	Procesi i Vendimmarrjes Zgjidhja e problemeve dhe menaxhimi i konfliktit.
<b>Kompetenca B</b> <b>Kompetenca G</b>	Kapitulli 4:Komunikimi dhe puna në skuadër	Shëndetësia elektronike dhe ICT, informacioni shëndetësor infermieristik. Puna ndërdisiplinare dhe shumëdisiplinare Komunikimi ndërpersonal Infermieristika multikulturore, puna me klientë multikulturore dhe në komunitete multikulturore.

		Aftësitë gjuhësore Përcjellja e njohurive
<b>Kompetenca A</b> <b>Kompetenca G</b>	Kapitulli:5 Kërkimi, zhvillimi dhe lidhshipi	Infermieristika e bazuar në evidencë në ndërthurje me të gjitha kompetencat. Parimet bazë të kërkimit, metodologjisë dhe terminologjisë. Inovacioni dhe përmirësimi i cilësisë në infermieristikë. Lidhshipi në infermieristikë, menaxhimi dhe vazhdimësia e kujdesit dhe shërbimit. Organizimi i shërbimeve shëndetësore dhe mjedisi i shërbimeve ndërsektoriale. Ergonomia e punës dhe siguria në punë.
<b>Kompetenca A</b> <b>Kompetenca D</b> <b>Kompetenca E</b>	Kapitulli:6 Kujdesi infermieror (edukimi teorik dhe trajnimi)	Procesi infermieror dhe dokumentacioni. Konceptet dhe teoritë e infermieristikës. Shkenca infermieristike. Anatomia dhe fiziologjia. Patologjia. Farmakologjia dhe biokimia. Sociologjia, psikologjia dhe pedagogjia. Nutricioni dhe dietetikët. Higjena, teknikat e sterilizimit, parandalimi i infeksioneve. Kontrolli i infeksioneve. Kujdesi paliativ, menaxhimi i dhimbjes dhe i fazës përfundimtare të jetës. Menaxhimi i sigurt i barnave dhe dhënia e recetës. Të monitorojë, vlerësojë dhe sigurojë aktivitetin jetësor të trupit, ndihmën e parë dhe reanimacionin. Parimet e infermieristikës, përfshirë kujdesin ndaj personit dhe kujdesin e vazhdueshëm, si dhe kompetencën klinike bazë që lidhet me kujdesin ndaj individëve, grupeve dhe familjeve gjatë ciklit jetësor dhe në situata të ndryshme, si edhe në fusha të ndryshme të specialistit klinici infermier.

## **Lista e përmbajtjes së kurrikulave të infermierit**

Më poshtë jepet lista e përmbajtjes e nxjerrë nga tabela e mësipërme. Kjo përmbajtje duhet të pasqyrohet në kurrikulat e infermierëve në formën e rezultateve të të mësuarit që u përgjigjen kompetencave të kërkuara. Ato janë klasifikuar sipas kompetencave specifike në Strukturën EFN të Kompetencave, por që gjithashtu mund të klasifikohen sipas kompetencave në Direktivën 2005/36/EC, të amenduar nga Direktiva 2013/55/EU.

**Kapitulli 1. Kultura, etika dhe vlerat**

- Etika, kodet e sjelljes dhe filozofia e infermieristikës, të drejtat e njeriut.
- Konfidencialiteti dhe zbulimi.
- Autonomia, të drejtat dhe siguria e pacientit.
- Aspektet ligjore të kujdesit shëndetësor dhe profesionit, legjislacioni social dhe i kujdesit shëndetësor.

**Kapitulli 2: Promocioni i shëndetit dhe parandalimi, drejtimi dhe****Mësimdhënia.**

- Parimet e shëndetit dhe sëmundjes.
- Shëndeti publik, promocioni i shëndetit dhe parandalimi, kujdesi parësor dhe komunitar.
- Drejtimi dhe edukimi shëndetësor i pacientit.
- Perspektivat dhe influencat sociale dhe ndërsektoriale.
- Fuqizimi dhe përfshirja e qytetarëve.

**Kapitulli 3: Vendimmarrja.**

- Procesi i vendimmarrjes.
- Zgjidhja e problemeve dhe menaxhimi i konflikteve.

**Kapitulli 4: Komunikimi dhe puna në skuadër**

- Shëndetësia elektronike dhe ICT, sistemet informatike të shëndetit dhe infermierit.
- Puna ndërdisiplinare dhe multidisiplinare.
- Komunikimi ndërpersonal.
- Infermieristika multikulturore, puna me klientë multikulturore dhe në komunitete multikulturore.
- Aftësitë gjuhësore.
- Përcjellja e njohurive.

**Kapitulli 5: Kërkimi dhe lidershipi.**

- Infermieristika e bazuar në evidencë.
- Parimet bazë të kërkimit, metodologjia dhe terminologjia.
- Inovacioni dhe përmirësimi i cilësisë në infermieristikë.
- Lidershipi dhe menaxhimi në infermieristikë.

- Organizimi i shërbimeve shëndetësore.

Punë ergonomike dhe siguria në punë.

Sipërmarrja.

### **CA.6. Kujdesi infermier (edukim teorik dhe trajnime)**

Teoritë dhe konceptet infermierore

Procesi infermieror, personi në qendër të kujdesit dhe dokumentacioni

Teoritë, konceptet infermierore dhe shkenca e infermierisë

Anatomia dhe fiziologjia

Patologjia

Farmakologjia dhe biokimia

Sociologjia, psikologjia dhe pedagogjia

Ushqyerja dhe dietat

Higjena, asepsia, prevenimi dhe kontrolli i infeksioneve

Kujdesi paliativ, fundi i jetës dhe menaxhimi i dhimbjes

Menaxhimi dhe përshkrimi i sigurt i medikamenteve

Të monitorosh, vlerësosh dhe sigurosh aktivitetin vital të trupit, ndihma e parë dhe reanimimi

Principet e infermierisë, duke përfshirë personin në qendër të kujdesit dhe kujdesin e vazhduar, dhe kompetencat klinike bazë në lidhje me kujdesin individual, grupet dhe familjet gjatë ciklit të jetës dhe vendosjet e ndryshme, gjithashtu edhe në fushat e ndryshme të specialistëve klinikë infermierë

Cilësia e kujdesit

Siguria e pacientit

Gatishmëria për situata kritike dhe katastrofa

### **CA.6. Kujdesi infermier (edukimi klinik – praktik dhe trajnimet)**

Kujdesi akut

Lindja, kujdesi pediatrik dhe për adoleshentët

Kujdesi për nënën

Kujdesi afatgjatë

Mjekësia interne dhe kirurgjia

Shëndeti mendor dhe sëmundjet psikiatrike

Paaftësia dhe kujdesi për personat e paaftë

Geriatria dhe kujdesi për të moshuarit

Kujdesi shëndetësor parësor, kujdesi për komunitetin

Kujdesi paliativ, fundi i jetës dhe menaxhimi i dhimbjes

**Lidhja midis kompetencave, përmbajtjes së kurrikulës së edukimit dhe të trajnimit si dhe rezultateve potenciale të të mësuarit.**

Rezultatet e të mësuarit janë një lloj deklarate që studenti e shpalos pasi ka përmbyllur procesin e edukimit dhe atë të trajnimit.

Çdo modul, temë apo lëndë duhet të ndërlidhet me disa kompetenca specifike, dhe në fund të përkthehet në rezultate të të mësuarit.

Rezultatet e mëposhtme potenciale të të mësuarit mund të specifikohen më tej dhe të lidhen në mënyrë të detajuar me lëndët mësimore.

**DIREKTIVA PËR KOMPETENCAT 36/55: Kompetenca H  
KOMPETENCA EFN N.1: Kultura, etika dhe vlerat**

**Përmbajtja**

**Rezultatet potenciale të të mësuarit**

Etika dhe filozofia e infermieristikës, të drejtat e njeriut. Autonomia, të drejtat dhe siguria e pacientit.  
Aspektet ligjore të kujdesit shëndetësor dhe profesioni, legjislatiioni social dhe ai i kujdesit shëndetësor.  
Konfidencialiteti

Të veprojë në mënyrë etike ligjore dhe humanitare gjatë dhënies së kujdesit infermieror ndaj pacientëve, familjeve dhe komunitetit.  
Të promovojë dhe respektojë të drejtat e njeriut dhe larmishmërinë ndërmjet njerëzve gjithmonë nën dritën e nevojave fizike, psikologjike spirituale dhe sociale të individëve të pavarur.  
T'u kushtojë rëndësi veprimeve si profesionist dhe të njohë limitet e të tjerëve në vënien në zbatim të kompetencave.  
T'u delegojë të tjerëve aktivitete të ndryshme gjithmonë në përputhje me aftësitë, shkallën e përgatitjes, shkallën e përfitimit dhe pikpamjes ligjore të praktikës.  
Të respektojë kërkesat etike dhe ligjore, duke përfshirë kodet kombëtare dhe ndërkombëtare të etikës dhe të kuptojë implikimet etike gjatë shpërhapjes së kujdesit shëndetësor.

**Direktiva e kompetencës 36/55: Kompetenca C**  
**Kompetenca EFN N. 2: Promovimi dhe parandalimi shëndetësor, drejtimi dhe**  
**mësimdhënia**

**Përmbajtja**

**Rezultatet potenciale të të mësuarit**

**Principet e shëndetit dhe sëmundjeve.**  
**Shëndeti publik, promovimi i shëndetit**  
**dhe parandalimi, kujdesi primar/**  
**komuniteti.**  
**Udhërrëfyesi i pacientit dhe edukimi**  
**shëndetësor**  
**Perspektivat ndërsektoriale, shoqërore**  
**dhe influenca**  
**Përfshirja dhe fuqizimi i shtetasve**

Të njohë rrishtun kryesor dhe faktorët mbrojtës të cilat influencojnë procesin e shëndetit dhe sëmundjeve.  
Të përfshijë grupet dhe komunitetet në edukimin shëndetësor dhe aktivitetet trajnuese, me qëllim forcimin e sjelljeve dhe adoptimin e një stili jete të shëndetshëm.  
Të sigurojë pacientët me mjetet që favorizojnë komplaincën e trajtimit dhe të identifikojë dhe monitorojë individët me një rrisht të lartë inkomplaincën e trajtimit e cila mund të paraqesë një rrisht tek vetë ata dhe tek komuniteti.  
Të aplikojë masa parandaluese për shëndetin e individëve dhe pacientëve përgjatë të gjithë stadeve të ciklit të jetës dhe në të gjitha fazat natyrale të historisë së sëmundjeve.  
Të drejtojë individët, pacientët dhe grupet me mënyrën se si të trajtojnë masat parandaluese të sëmundjeve dhe si të përdorin shërbimet e ofruara nga sistemi i kujdesit shëndetësor.  
Të fuqizojë individët duke implementuar aktivitete edukimi për kujdesin shëndetësor, të cilat i lejojnë ata të jenë të pavarur sa më shumë të jetë e mundur dhe gjithashtu të marrin vendime për shëndetin dhe sëmundjet e tyre.

**Direktiva e kompetencës 36/55: Kompetenca A dhe F**  
**EFN kompetenca N.3: Vendim – marrja**

24

Përmbajtja	Rezultatet potenciale të të mësuarit
<p><b>Vendim – marrja është një kompetencë ndërseksionale, e cila duhet të zhvillohet gjatë kurrikulave.</b></p> <p><b>Në fund, është e rëndësishme të krijohen rezultatet e të mësuarit, të cilat mund të vlerësohen duke ndjekur rrugën ndërsektoriale.</b></p>	<p>Të përdorë eksperiencën dhe arsye të përbashkëta për të identifikuar problemet dhe situatat dhe gjithashtu për t'i zgjidhur ato.</p> <p>Të njohë mundësitë për të gjetur alternativat më të mira dhe për të vendosur për veprimet më të mira, për të zgjidhur problemet.</p> <p>Të zgjidhë në mënyrë sa më efektive problemet që dalin gjatë ofrimit të kujdesit ndaj pacientëve, familjes dhe komunitetit, duke kapitalizuar në materiale dhe burime të përkohshme.</p>

**Direktiva e kompetencës 36/55: Kompetenca B dhe G**  
**EFN kompetenca N.4: Komunikimi dhe bashkëpunimi**

Përmbajtja	Rezultatet potenciale të të mësuarit
<p><b>Shëndeti elektronik dhe ICT, shëndeti dhe sistemet e informimit në infermieri.</b></p> <p><b>Puna interdisiplinare dhe multidisiplinare</b></p> <p><b>Komunikimi interpersonal.</b></p> <p><b>Infermiera multikulturale, të punuarit me klientë multikulturalë dhe në komunitete multikulturale</b></p> <p><b>Aftësitë gjuhësore</b></p> <p><b>Transferimi i njohurive</b></p>	<p>Të përdorë sistemet IT të vlefshme në sistemin e kujdesit shëndetësor të tyre.</p> <p>Të aplikojë teknologjitë e kujdesit shëndetësor dhe sistemet e komunikimit dhe informimit.</p> <p>Të komunikojë qartë, duke treguar respekt dhe autoritet demokratik me skuadrën e kujdesit shëndetësor, pacientët, familjarët dhe komunitetin, duke marrë në konsideratë përmbajtjen multikulturale.</p> <p>Të përdorë gjuhën shkencore në të folur dhe të shkruar, duke e adoptuar atë në bazë të personit të cilit i adresohet.</p> <p>Të krijojë qartë objektivat së bashku me kolegët, gjithashtu edhe me skuadrën multi dhe interdisiplinare për të arritur qëllimet e përbashkëta, duke pranuar ndryshimet e nevojshme për të arritur objektivat.</p> <p>Të marrë përgjegjësitë në rolin e anëtarit të skuadrës multidisiplinare.</p> <p>Të tregojë një qëndrim të orientuar drejt përmirësimit të vazhduar.</p> <p>Të jetë i përkushtuar për të bashkëpunuar</p>

**Direktiva e kompetencës 36/55: Kompetencat A dhe G**  
**Kompetencat EFN N. 5: Kërkim, zhvillim dhe lidërsip**

<b>Përmbajtja</b>	<b>Rezultatet potenciale të të mësuarit</b>
<p><b>Evidenca të bazuara në prirjet dhe dëshmitë e kompetencave infermierore.</b></p> <p><b>Bazat e hulumtimit, metodologjisë dhe terminologjisë Inovative dhe përmirësimi i cilësisë në infermieri.</b></p> <p><b>Udhëheqja infermierore, menaxhimi dhe vazhdimësia e kujdesit dhe shërbimeve.</b></p> <p><b>Organizim i shërbimeve shëndetësore dhe mjedisi ndërsektorial.</b></p> <p><b>Ergonomia dhe siguria në punë</b></p>	<p>Të sigurojë kujdes infermieror bazuar në prova shkencore, në mënyrë që të ofrojë rezultate të sigurt dhe me cilësi të lartë.</p> <p>Të aplikojë metodologjinë bazë infermierore, si dhe parimet teorike duke vënë në dispozicion burimet shkencore.</p> <p>Të marrë pjesë në mënyrë aktive në forume profesionale dhe në programe edukimi të vazhdueshme.</p> <p>Të jenë përgjegjës për zhvillimin e tyre profesional në përputhje me zhvillimet e fundit shkencore dhe teknologjike.</p> <p>Të njohin karakteristikat për udhëheqje, të cilat janë të nevojshme për të koordinuar ekipe shëndetësore.</p> <p>Të identifikojnë karakteristikat dhe funksionin e menaxhimit në shërbimin infermieror dhe menaxhimin e kujdesit.</p> <p>Të kuptojnë fazat e ndryshme të procesit të administrimit: planifikimin, organizimin, menaxhimin, vlerësimin dhe kontekstualizimin e saj në shërbimet infermierore, për të përshtatur stilet e lidërsipit dhe qasjet në situata të ndryshme.</p>

**Direktiva e Kompetencës 36/55: Kompetencat A,D dhe E  
Kompetencat e EFN. 6: Kujdesi infermieror (edukim teorik dhe trajnime)**

**PËRMBAJTJA**

Procesi infermieror dhe dokumentacioni

Teoritë dhe konceptet infermierore, si dhe shkenca e infermierisë

Anatomi dhe Fiziologji

Patologji

Farmakologji, biokimi, sociologji dhe pedagogji nutricionë dhe dietetikë

Higjena, asepsia, parandalimi i infeksioneve, kontrolli

Kujdesi paliativ, fund i jetës dhe menaxhimi i dhimbjes

Menaxhimi i sigurt i medikamenteve dhe përshkrimi i tyre

Monitorimi, vlerësimi dhe sigurimi i aktivitetit vital të trupit, dhënia e ndihmës së shpejtë.

Principet infermierore, përfshirja e pacientëve në qendër të kujdesit, kujdesi i vazhduar dhe ofrimi i kompetencave në lidhje me kujdesin e individëve, grupeve dhe familjarëve gjatë ciklit të jetës në fusha të ndryshme si dhe në infermierë të specializuar në fusha të ndryshme.

Cilësia e jetës

Siguria e pacientit

Gatishmëria në raste fatkeqësie dhe situata kritike.

### Anatomi, fiziologji, patologji

- Të njohë dhe identifikojë strukturën dhe funksionimin e trupit të njeriut.
- Të njohë proceset psikopatologjike dhe shfaqjen e tyre, si dhe faktorët e rrishtit që përcaktojnë shëndetin dhe sëmundjen në stadi të ndryshme të ciklit jetësor.
- Të njohë evoluimet më të mundshme dhe nëse janë të besueshme, si dhe komplikacionet, të cilat mund të na çojnë në procese patologjike kryesore.
- Të përvetësojë terminologjinë e duhur të simptomave dhe shenjave dalluese kryesore për t'u përshtatur me entitetet e ndryshme fiziopatologjike.

### Psikologji

- Të identifikojë reagimet psikosociale të individëve në situata të ndryshme shëndetësore.
- Të identifikojë veprimet e duhura për t'u dhënë ndihmë njerëzve, në bazë të reagimeve të tyre psikosociale në situata të ndryshme shëndetësore.

### Biokimia

- Të kuptojë origjinën molekulare të funksioneve bazë të qenies njerëzore dhe të vlerësojë proceset biokimike në jetën e përditshme dhe në situata të shëndetit dhe sëmundjes.
- Të njohë procesin e çlirimit, ruajtjes dhe përdorimit të energjisë metabolike.
- Të njohë bazën molekulare të rrugëve të ndryshme metabolike, si dhe ndërlikimin midis indeve të ndryshme.
- Të njohë sistemet molekulare dhe proceset e përfshira në ruajtjen, përsëritjen dhe dhënien e informacionit genetik.
- Të kuptojë ndryshimet molekulare që shoqërohen me situata të ndryshme psikosociale (të mbash kreshmë, të ushtrohesh fizikisht, shtatzani) dhe kushtet patologjike (diabeti).
- Të kuptojë ndikimin e ndryshimeve genetike në disa sëmundje të caktuara njerëzore.
- Të përdorë siç duhet terminologjinë e biokimisë.

### Nutricioni dhe dietetikët

- Të identifikojë dhe klasifikojë ushqimet dhe produktet ushqimore
- Të dijë të analizojë dhe përcaktojë kompozimin, vlerat ushqimore, vlerat biologjike të ushqyesve të tyre, karakteristikat organoleptike dhe modifikimet që ato pësojnë si rrjedhim i proceseve teknologjike dhe atyre kulinare.

- Të njohë proceset bazë të bërjes, transformimit, ruajtjes dhe origjinën e frutave dhe mishit
- Të hartojë, të interpretojë dhe trajtojë tabela dhe databaza me përmbajtjen ushqimore.
- Të njohë mikrobiologjinë, parazitologjinë dhe toksikologjinë e ushqimeve
- Të njohë përbërësit, funksionin e tyre në organizëm, aftësitë biologjike, nevojat dhe rekomandimet, bazat e energjisë dhe balancat ushqimore.
- Të integrojë dhe të vlerësojë marrëdhënien midis marrjes së ushqimeve dhe elementëve të shëndetshëm në rastet e patologjive

### **Farmakologji**

- Të identifikojë grupet e ndryshme të medikamenteve.
- Të identifikojë veprimin e medikamenteve të cilat konsiderohen farmakokinetike dhe farmakodinamike. Të përshkruajë mekanizmin veprues të medikamenteve të ndryshme.
- Të përshkruajë llojet e ndryshme të administrimit të medikamentit, mënyrën dhe dozën.
- Të përshkruajë veprimet kryesore të medikamenteve që lidhen me kontrollin dhe indikacionin.
- Të përshkruajë përfitimet nga grupe të ndryshme medikamentesh dhe produkte të shëndetit që mund të ketë një pacient.
- Të identifikojë ndërveprimet që mund të ndodhin ndërmjet grupeve të ndryshme të medikamenteve dhe produkteve të tjera kur përdoren njëkohësisht.
- Të identifikojë rrethanat më të rëndësishme që modifikojnë veprimet e mjekësisë, të lidhura me: efektet toksike, ndërveprim ushqim- mjekësi, ruajtjen e ilaçeve dhe të tjerët.
- Të identifikojë kundërrindikimet e medikamenteve dhe produkteve të kujdesit shëndetësor në varësi të gjendjes së pacientit.
- Të përshkruajë efektet anësore të barnave dhe produkteve të kujdesit shëndetësor në bazë të llojit dhe të patologjisë që ata kanë përcaktuar për të, duke marrë parasysh pacientin dhe evolucionin e tij / të saj.
- Të lidhet me tregues të grupeve të ndryshme të barnave dhe produkteve të kujdesit shëndetësor për nevojat e kujdesit të pacientëve.
- Të përshkruajë mënyrat e administrimit të barnave dhe rrethanat specifike për të përgatitur ilaçe për një përdorim optimal.

- Të identifikojë barnat për trajtim, administrim apo kontrollin e tyre duke i përfshirë ata në grupin përkatës dhe duke përmendur karakteristikat e tij kryesore.
- Të zotërojë teknikat e ndryshme për përgatitjen e ilaçeve, për administrimin e tyre të menjëhershëm të të sëmurët.
- Të tregojë aftësitë për të administruar në mënyrë të sigurt produktet e kujdesit shëndetësor të lidhura me kujdesin infermieror.
- Rezultatet e mësimit në përshkrimin e recetave duhet të rishikohen.

### **Përshkrimi**

- Të identifikojë produkte shëndeti të cilat lidhen me kujdesin infermieror.
  - Të identifikojë medikamente dhe produkte shëndeti të cilat mund të rekomandohen nga vetë infermierët duke i identifikuar grupet përkatëse dhe të përshkruajnë karakteristikat e tyre.
  - Të përshkruajë principet e autorizimit, përdorimin dhe indikacionet.
  - Të interpretojë me saktësi përshkrimin farmakologjik duke specifikuar profesionet e ndryshme dhe rrethanat e përfshira.
  - Të analizojë përshkrimin ideal për individin nëpërmjet elementeve terapeutikë të gjykimit.
  - Të njohë efektet anësore kryesore të barnave dhe të përshkruajë qëndrimin në raste të tilla.
  - Të integrohet me procesin e përshkrimit të recetave sipas metodologjisë së infermierëve, duke marrë parasysh elementët bioetikë për zhvillimin e saj.
- Të përshkruajë mbështetjen konceptuale dhe ligjore të përshkrimit të recetës nga infermierët dhe mënyrën se si ajo i përshtatet me terapinë e përgjithshme.

### **Siguria dhe cilësia**

- Të krijojë dhe mirëmbajnë një ambjent të sigurtë gjatë ofrimit të kujdesit duke përdorur strategji për sigurimin e cilësisë dhe menaxhimin e riskut.
- Të përdorë instrumentat e duhur për vlerësim dhe të identifikojnë rrisqet aktualë dhe potencialë.
- Të komunikojë dhe të regjistrojë problemet e sigurisë në autoritetet kompetente.

### **Higjena, asepsia, parandalimi i infeksioneve, kontrolli i infeksioneve**

- Të aplikojë masa për kontrollin dhe njohjen e zinxhirit epidemiologjik duke përdorur teknika të rëndësishme të mbrojtjes dhe parandalimit.

- Të përgatisë materialet dhe pajisjet për pastrim dhe dezinfektim.
- Të aplikojë teknikat e sterilizimit, sipas kriterëve të cilësisë së këtij shërbimi.
- Të eliminojë mbetjet dhe produktet duke ndjekur rregulloret në fuqi dhe në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm.

### **Procesi infermieror dhe dokumentimi: Teoritë infermierore dhe kompetencat në shkencën infermierore**

- Të identifikojë Kornizën Konceptuale për Kujdesin Infermieror
- Të njohë konceptet të cilat udhëheqin fenomenin e disiplinës infermierore.
- Të identifikojë modelet më të rëndësishme teorike infermierore.
- Të përshkruajë bazat teorike të metodologjisë infermierore.
- Të njohë teoritë kryesore të infermierisë.
- Të kryejë planin e kujdesit sipas gjuhës infermierore dhe klasifikimit ndërkombëtar.

### **Kujdesi Paliativ, fund i jetës dhe menaxhimi i dhimbjes**

- Të përshkruajë, kuptojë dhe analizojë konceptet kyçe dhe principet e kujdesit paliativ.
- Të kuptojë konceptin e pacientit të brishtë.
- Të identifikojë ndryshimet tek pacientët gjatë ditëve të tij/ të saj të fundit.
- Të njohë burimet ekzistuese për të referuar pacientët me probleme të shumta.
- Të njohë dhe të kuptojë faktorët kulturorë në lidhje me vdekjen dhe mënyrat e vdekjes.
- Të njohë rolet e anëtarëve të ndryshëm të skuadrës mjekësore dhe sociale dhe të njohë rëndësinë e ndërhyrjeve interdisiplinare.

### **Sociologji**

- Të kontekstualizojë kujdesin duke u bazuar në faktorët socialë që e influencojnë atë.
- Të përshkruajë koncepte historike dhe zhvillimet e fundit të teorive antropologjike dhe sociale.
- Të deklarojë kontributet e bëra nga disiplinat e antropologjisë dhe sociologjisë për studimet e procesit shëndet- sëmundje.
- Të identifikojë lidhjen midis aspekteve biologjike, kulturore dhe sociale në ndërtimin e shëndetit dhe procesin e sëmundjes.

- Të shpjegojë se si mund të ndihmojnë teoritë antropologjike dhe sociale që të ofrojnë një kujdes shëndetësor të ndjeshëm dhe të qëndrueshëm me diversitetin social, ekonomik, politik dhe kulturor.
- Të njohë sistemet shëndetësore individuale ose grupet dhe të përcaktojë vlerat e stilit të jetës, sjellje të shëndetshme dhe eksperiencat të sëmundjes.
- Të shpjegojë shumëllojshmërinë e sjelljeve dhe të kërkojë ndihmë kur shfaqen simptoma të shumta të sëmundjes.

#### Pedagogji

- Të identifikojë nevojat për edukim dhe trajnime.
- Të planifikojë procesin e mësimdhënies dhe të të mësuarit duke konsideruar zhvillimin e kompetencave, metodat për zhvillim dhe vlerësim.

#### Ndihma e parë dhe reanimimi kardiopulmonar

- Të përcaktojë konceptet e "mbështetjes bazë jetike" dhe "arrestit Kardio-respirator".
- Të identifikojë rastet në të cilat reanimimi është i këshilluar.
- Të njohë teknikat kryesore për të vlerësuar orët e fundit të jetës.
- Të krijojë indikacionet për ndërhyrje për të ndihmuar një pacient i cili vuan nga një arrest kardiorespirator.
- Të përcaktojë sekuencën e veprimeve në mbështetje themelore jetësore.
- Të njohë gabimet më të zakonshme gjatë kryerjes së reanimimit gjatë arrestit kardio-respirator.
- Të njohë komplikacionet më të shpeshta të arrestit kardio-respirator.
- Të identifikojë rreziqet që lidhen me profilin e respiracionit të drejtuar.

#### Gatishmëria për situatat kritike dhe fatkeqësitë

- Të dallojë konceptin "katastrofë", nga ai i "aksident me viktima të shumta".
- Të tregojë mënyrat se si duhet të transferohet në mënyrë adekuate dikush që ka pësuar një aksident në drejtim të një qendre shëndetësore, në kushte të përshtatshme dhe në mënyrë sa më efikase.
- Të dallojë konceptin e "përzgjedhjes" brenda një "katastrofe" nga ai i "klasifikimit" në situata "aksident me viktima të shumta".
- Të listojë nivelet e ndryshme të prioriteteve në lidhje me ndihmën terapeutike për viktimat.

- Të citojë hapat që duhen ndjekur për të hartuar një plan veprimi sipas burimeve në dispozicion.
- Të klasifikojë veprimet që duhet të kryhen në raste të incidenteve bërthamore, radiologjike, rreziqet kimike ose biologjike.

### Kompetencat e Direktives 36/55: Kompetencat A dhe E të Kompetencave sipas EFN

#### N. 6: Kujdesi Infermieror (edukimi dhe trajnimet në praktikën klinike)

PËRMBAJTJA	Rezultatet e mundshme të të mësuarit
<p><b>Kujdesi akut për të porsa-lindurin, kujdesi pediatrik dhe në adoleshencë, Kujdesi për nënën.</b></p> <p><b>Kujdesi afat-gjatë mjekësia e përgjithshme interne, kirurgjia e shëndetit mendor dhe sëmundjet psikiatrike</b></p> <p><b>Paaftësia dhe kujdesi për të paaftët, kujdesi geriartrik</b></p> <p><b>Kujdesi për të moshuarit</b></p> <p><b>Kujdesi parësor</b></p> <p><b>Kujdesi në komunitet</b></p> <p><b>Kujdesi paliativ, kujdesi nëfund të jetës dhe menaxhimi i dhimbjes</b></p>	<p>Rezultatet e mëposhtme mbi të mësuarit duhet të jenë:</p> <p>Kontekstualiiimit në bazë të llojit të pacientit dhe momentit të ciklit jetësor në fjalë, duke marrë parasysh edhe nëse sëmundja është në fazën akute ose kronike, dhe të nivelit të kujdesit. Ajo mund të specifikohet më tej në bazë të çdo përmbajtje.</p> <p>N. 6.1. - Vlerësimi dhe diagnoza</p> <p>Për të njohur faktorët e rrisht biologjik, social, psikologjik dhe mjedisor që mund të kenë ndikim në shëndetin e njerëzve.</p> <p>Të pyesë njerëzit, pacientët dhe familjet për nevojat e tyre psiko-sociale dhe shpirtërore për të mbuluar ato në trajtimin e tyre.</p> <p>Të vlerësojë aftësitë fizike, psikologjike dhe aspektet social-kulturale të individit.</p> <p>Të identifikojë kujdesin e individit dhe pacientit nëpërmjet kërkesës gjatë gjithë ciklit të tyre të jetës me anë të testeve fizike, vëzhgimit, dhe mjetet adekuate terapeutike.</p> <p>Të kryejë një vlerësimim dhe diagnozë infermiore dhe të krijojë një lidhje midis indikacioneve dhe përdorimit të produkteve të kujdesit shëndetësor.</p>

### **N. 6.2. – Plani i kujdesit**

Të përcaktojë përparësitë dhe të delegojë ndërhyrjet sipas kërkesave të pacientit, familjes dhe komunitetit:

Për të krijuar një plan të ndërhyrjes infermierore.

Për të përshtatur planin e kujdesit me karakteristikat e pacientëve, kontekstit dhe mjedisit të tyre.

Për të planifikuar kujdes të integruar në përdorimin e ilaçeve dhe produkteve të kujdesit shëndetësor.

### **N. 6.3. – Ndërhyrjet infermierore**

Të ofrohet një kujdes i bazuar tek nevojat e pacientëve, duke treguar një zhvillim dhe rritje në të kuptuarit e qenies humane, fiziopatologjinë dhe farmakologjinë në kuadrin shëndetësor si dhe duke marrë parasysh vazhdimësinë e sëmundjeve.

Të aplikojë një kujdes infermieror, duke siguruar qëndrueshmëri në sistemin shëndetësor.

Të përfundojë regjistrimet mbi aktivitetet e kryera. Të aplikojë aftësitë e të menduarit kritik dhe një qasje të sistemeve për zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve infermierore ndërmjet një sërë profesioneve dhe në kontekstin e ofrimit të tij.

Të përgjigjet në mënyrën e duhur dhe në kohë, mbi situata të papritura dhe ato që ndryshojnë me shpejtësi.

### **N. 6.4. Vlerësimi dhe cilësia**

Të identifikojë dhe të mbledhë prova për aktivitetet e kujdesit. Të marrë në konsideratë protokollet e vendosura nga ana e modeleve të ndryshme të cilësisë së përcaktuar.

Të vlerësojë zbatimin e planeve të kujdesit, të procesit të dhënave dhe të shqyrtojë provat, vlerësimin e efektivitetit të veprimeve të kryera.

Të hartojë dhe të zbatojë planet e përmirësimit.  
Të sigurojë asistencë infermiore të sigurtë dhe të ofrojë me cilësi kujdes për individët dhe pacientët gjatë gjithë ciklit të jetës.

Të krijojë mekanizma të vlerësimit dhe procese për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së kujdesit infermior duke marrë në konsideratë zhvillimet shkencore, teknike dhe etike.

## Përmbledhje e termave kyçe

### Funksion

Kjo është një detyrë apo përgjegjësi e cila lidhet me një punë të veçantë. Kjo nënkupton disa detyra. Një funksion është përdorur në lidhje me punën e caktuar për një person dhe pritshmëritë e personit brenda një mjedisi pune.

### Kompetenca

Kjo është një ndërthurje midis njohurive, shkathtësive, qëndrimeve dhe vlerave, si dhe mobilizimi i komponentëve të veçantë për t'i transferuar ato në një kontekst të caktuar ose situatë reale, kështu që, vjen me veprim më të mirë / zgjidhje të mundshme, për të adresuar të gjitha situatat e ndryshme dhe problemet që mund të dalin në çdo moment, duke e bërë përdorimin e burimeve të disponueshme.

Kompetencat e përcaktuara nga EFQ janë "kompetenca" që nënkuptojnë aftësi të provuara për të përdorur njohuritë, aftësitë personale, shoqërore dhe / ose metodologjike në punë, ose për të studiuar situatat dhe zhvillimin profesional dhe personal. Në kuadër të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, kompetenca është përshkruar në terma të përgjegjësisë dhe autonomisë.

#### Kompetencat specifike

Janë ato kompetenca të cilat përfshihen në kërkesat e një pune të veçantë në përputhje me veçoritë e saj. Ato janë të lidhura me disiplina specifike, sektorë ose kualifikime, dhe ata kanë për qëllim arritjen e një profil të veçantë diplomimi.

#### Kompetencat ndërsektoriale

Janë ato kompetenca të përbashkëta nga të gjitha subjektet ose fusha të ndryshme njohurish, të cilat janë të zakonshme për shumicën e kualifikimeve, edhe pse ato prodhojnë një efekt të ndryshëm dhe kontekstualizohen në secilën prej këtyre kualifikimeve.

### Rezultatet e të mësuarit

Këto janë deklaratat të cilat nxënësit pritet që t'i dijë, t'i kuptojë dhe të jetë në gjendje t'i tregojnë pas përfundimit të një procesi të të mësuarit (moduli, lënde, çështje, kursi, etj). Ata fokusohen në atë që studenti ka arritur dhe jo tek qëllimet e mësuesit. Ato përqëndrohen në atë që studenti do të jetë në gjendje të tregojë një herë pasi ka përfunduar aktivitetin e tij / të saj të të mësuarit.

**Kriteret e performancës**

Ata shprehin nivelin e pranueshëm në lidhje me performancën profesionale që **përbush objektivat e organizatave produktive dhe përbën një udhëzues të vlerësimit** për kompetencë profesionale.

**Evidenca ose regjistrime**

Është një dokument që tregon rezultatet e arritura ose jep dëshmi në lidhje me aktivitetet e kryera.

**Indikatori**

Ajo është e një e dhënë ose një set të dhënash, të cilat ndihmojnë për të matur objektivisht ecurinë e një procesi apo një aktiviteti. Rezultatet e arritura janë tregues/indikatorë.

**Standardi**

Niveli optimal i performancës me qëllim arritjen e një niveli të caktuar.

**Niveli minimum i kërkuar**

Kjo do të jetë standardi ynë.